



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Qeveria –Vlada-Government  
Ministria e Drejtësisë- Ministarstvo Pravde- Ministry of Justice

---

## VLERËSIM KRAHASUES I TË DHËNAVE MBI FUNKSIONIMIN E SISTEMIT TË DREJTËSISË NË KOSOVË (2014 - 2020)

*I bazuar në metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ) për vlerësimin e sistemeve gjyqësore*

Shkurt 2022



*Përgatitja e këtij raporti u mbështet nga Projekti i përbashkët i Bashkimit Evropian dhe Këshillit të Evropës "KoSEJ II", pjesë e programit Instrumenti Horizontal II. Pikëpamjet e shprehura këtu, në asnjë rast nuk pasqyrojnë opinionin zyrtar të Bashkimit Evropian ose të Këshillit të Evropës.*

## Përmbajtja

HYRJE .....	3
1. TË DHËNAT EKONOMIKE DHE DEMOGRAFIKE.....	5
2. BURIMET BUXHETORE.....	6
<b>2.1. Buxheti i sistemit gjyqësor</b> .....	6
<b>2.2. Buxheti për gjykatat</b> .....	8
<b>2.3. Buxheti për prokurorinë publike</b> .....	11
<b>2.4. Buxheti për ndihmën juridike</b> .....	12
<b>2.5. Zhvillimet në gjendjen e teknologjisë së informacionit (TI)</b> .....	14
3. PROFESIONISTËT.....	15
<b>3.1. Gjyqtarë profesionistë</b> .....	15
<b>3.2. Stafi jo-gjyqtarë</b> .....	18
<b>3.3. Prokurorët</b> .....	19
<b>3.4. Stafi jo-prokurorë</b> .....	21
<b>3.5. Pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve</b> .....	22
<b>3.6. Avokatët</b> .....	23
4. EFIKASITETI I VEPRIMTARISË SË GJYKATAVE DHE PROKURORIVE.....	24
<b>4.1. Lëndët civile dhe ekonomike në procedure kontestimore: ngarkesa me lëndë dhe treguesit e performancës</b> .....	25
<b>4.2. Lëndët administrative: ngarkesa me lëndë dhe treguesit e performancës</b> .....	31
<b>4.3. Lëndët penale: ngarkesa me lëndë dhe treguesit e performancës</b> .....	33
<i>Ngarkesa me lëndë në prokurori</i> .....	33
<i>Ngarkesa e gjykatës me lëndë</i> .....	35
5. PËRFUNDIME.....	42




## HYRJE

Ky raport paraqet të dhënat mbi efikasitetin e sistemit e drejtësisë të Kosovës të bazuar në metodologjinë e Komisionit Evropian për Efikasitetin e Drejtësisë (CEPEJ), dhe tregon evolucionin e bërë gjatë një periudhe shtatë vjeçare (2014 - 2020), përmes katër shtyllave matëse (2014, 2017, 2018 dhe 2020). Ai është i katërti i këtij lloji.<sup>1</sup>

Përgatitja e këtij raporti nuk do të ishte e mundur pa angazhimin e lartë të institucioneve vendore, të cilët mblodhën të dhënat dhe dokumentet, andaj duhen falënderuar këto institucione: **Këshilli Gjyqësor i Kosovës (KGJK), Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK), Agjencia për Ndihmë Juridike Falas dhe Oda e Avokatëve**. Më konkretisht, ne i falenderojmë pikat e kontaktit në institucionet relevante për angazhimin e tyre të vazhdueshëm që nga raporti i parë i përgatitur në vitin 2017, në veçanti: znj. Fatmire Krasniqi, znj. Valdete Mustafa, z. Ilaz Papaj, dhe z. Besnik Ramosaj nga KGJK; znj. Margarita Gjocaj, z. Valon Jupa, z. Naser Hasani, z. Nexhat Haziri dhe z. Besim Morina nga KPK; znj. Albulena Ukimeraj nga OAK; znj. Flutura Zena nga ANJF; z. Egzon Osmanaj nga MD dhe koordinatorët nga MD znj. Albulena Uka dhe z. Ruzhdi Osmani.

Qëllimi i këtij prezantimi është identifikimi i evoluimit të trendeve. Ajo që e dallon atë nga raportet e tjera të lëshuara nga institucionet e drejtësisë në Kosovë (p.sh. raportet vjetore të KGJK-së dhe KPK-së) është qasja gjithëpërfshirëse ndaj vlerësimit të sistemit gjyqësor dhe ndërveprimit midis komponentëve të ndryshëm të veta, siç janë buxhetet, stafi, efikasiteti:



<sup>1</sup> Raportet e mëparshme janë në dispozicion këtu: *Raport vlerësimi për sistemin e drejtësisë në Kosovë*, të dhënat e vitit 2014, u publikua në janar të vitit 2018. Vlerësimi i vitit 2014 ofron një bazë unike për t'u përdorur si pikë referimi për të matur trendet dhe evoluimin që nga ai vit. Rekomandimi 19 i këtij raporti theksoi se sistemi gjyqësor në Kosovë duhet të vlerësohet në bazë të rregullt, bazuar në metodologjinë CEPEJ, në mënyrë që të përmirësojë kualitetin dhe efikasitetin e tij (<https://rm.coe.int/assessment-report-2018-albanianizvestaj-o-proceni-pravosudnog-sistema/16807828e8>); *Vlerësimi krahasues i sistemit e drejtësisë në Kosovë, nga 2014 deri në 2017* (<https://rm.coe.int/vleresim-krahasues/1680939687>); *Vlerësimi krahasues i sistemit e drejtësisë në Kosovë, 2014, 2017 dhe 2018* (<https://md.rks-gov.net/desk/inc/media/77344FC5-D450-4BF3-954D-D20E1F0C3E14.pdf>).

Ky vlerësim bazohet në Skemën e vlerësimit të CEPEJ posaçërisht të adaptuara për Kosovën - e njëjta është përdorur në vlerësimet e mëhershme. Projekti rajonal i CEPEJ-it "Dashboard Western Balkans" mbledh të dhëna të ngjashme.

Të dhënat u verifikuan bazuar në udhëzimet "know-how" të përgatitura nga projekti i KoSEJ.<sup>2</sup> Qëllimi është të sigurohet një përdorim i saktë të metodologjisë të CEPEJ dhe të kontribuohet drejt një cilësie të shtuar të të dhënave të mbledhura, që lejon krahasime kuptimore dhe vlerësime të evoluimeve gjatë asaj kohe.

Viti 2020 ishte një vit shumë i veçantë për shkak të krizës pandemike që ka prekur gjithë botën. Në Kosovë, nga mesi i marsit 2020 deri në fillim të qershorit 2020, gjykatat u mbyllën pothuajse plotësisht: ato merreshin vetëm me çështje urgjente, si masat e paraburgimit, rastet e dhunës në familje. Nga 1 qershori, gjykatat filluan sërish të punojnë plotësisht dhe seancat rifilluan sërish, fillimisht pa praninë e publikut dhe më pas, në mënyrë progresive, me prezencë të kufizuar të publikut. Ndikimi i COVID-19 në të gjithë sistemin e drejtësisë nuk mund të injorohet.

Raporti është i organizuar në 4 kapituj, të cilët i prezantojnë:

- të dhënat ekonomike dhe demografike (Kapitulli 1);
- burimet buxhetore (Kapitulli 2);
- profesionistët (Kapitulli 3);
- dhe efikasitetin e veprimtarisë së gjykatave dhe prokurorive (Kapitulli 4).

---

<sup>2</sup> UDHËZIME PËR MBLEDHJEN DHE ANALIZIMIN E TË DHËNAVE PËR TË VLERËSUAR FUNKSIONIMIN E SISTEMIT E DREJTËSISË BAZUAR NË METODOLOGJINË E KOMISIONIT EVROPIAN PËR EFIKASITETIN E DREJTËSISË (CEPEJ) PËR VLERËSIMIN E SISTEMEVE GJYQËSORE. Udhëzimet "know-how" janë pilotuar/testuar gjatë procesit të mbledhjes së të dhënave midis janarit dhe marsit 2021 së bashku me pikat e kontaktit në institucionet përkatëse, dhe më pas janë dorëzuar më 1 korrik 2021.

## 1. TË DHËNAT EKONOMIKE DHE DEMOGRAFIKE


Të dhënat e përgjithshme ekonomike dhe demografike (P1, P3, P4)			
	Numri i banoreve	BPV per banor (€)	Paga mesatare vjetore bruto (€)
Kosova 2014	1,852,341	3,054 €	4,836 €
Kosova 2017	1,798,506	3,390 €	5,172 €
Kosova 2018	1,795,666	3,630 €	5,436 €
Kosova 2020	1,798,188	3,772 €	5,592 €

- Nga viti 2014 deri në vitin 2018 numri i banorëve ka rënë, por nga viti 2018 deri në vitin 2020 numri i banorëve ka pasur një rritje të lehtë.
- BPV-ja për banorë (në €) është rritur ngadalë që nga viti 2014. Ky tregues është i rëndësishëm për analizën e mëposhtme, veçanërisht kur shikohet: buxheti i gjykatave për banorë dhe numri i gjyqtarëve dhe prokurorëve për banorë.
- Paga mesatare vjetore bruto gjithashtu ka ardhur duke u rritur ngadalë që nga viti 2014 (<https://ask.rks-gov.net/media/6030/niveli-i-pagave-në-kosovë-2020.pdf>). Ky tregues është i rëndësishëm kur shikojmë më poshtë pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

## 2. BURIMET BUXHETORE


### 2.1. Buxheti i sistemit gjyqësor

Shikoni Fjalorin e CEPEJ këtu, <https://rm.coe.int/cepej-glossary-albanian/1680a02c14>, page 4:



		Gjykata	Prokuroria	Ndihma juridike
2014	Miratuar	19,431,805 €	6,736,947 €	930,303 €
	Zbatuar	18,230,066 €	5,944,818 €	1,076,321 €
2017	Miratuar	20,864,894 €	8,906,943 €	1,376,312 €
	Zbatuar	18,558,891 €	7,728,569 €	1,749,628 €
2018	Miratuar	26,656,957 €	12,038,853 €	1,786,752 €
	Zbatuar	26,596,256 €	11,738,004 €	1,775,811 €
2020	Miratuar	27,265,668 €	13,251,585 €	1,523,373 €
	Zbatuar	26,283,996 €	12,924,294 €	1,443,569 €

### Buxheti i sistemit gjyqësor sipas kategorive



- Bazuar në definicionet e CEPEJ-it, buxheti për gjykata është buxheti i KGJK-së pa ndihmë juridike. Në mënyrë të ngjashme, buxheti i prokurorisë është buxheti i KPK-së pa ndihmë juridike.
- Për sa i përket buxhetit për ndihmë juridike, së pari është e rëndësishme të kujtojmë sa vijon, bazuar në përkufizimet dhe metodologjinë e CEPEJ-it: Nuk ka asnjë shpenzim vetëm për ndihmë juridike në Kosovë, sepse gjykatat/KGJK-ja dhe ANJF-ja janë të përfshira në dhënien e ndihmës juridike falas. Për më tepër, kur emërohet një avokat falas gjatë fazës paraprake të procedurave penale, kostot e lidhura me shpenzimet e KPK-së. Shifra totale e buxhetit të aprovuar merret duke marrë burime të ndryshme, përkatësisht: (i) burimet e veçanta për ndihmë juridike në KGJK; (ii) burimet e veçanta për ndihmë juridike në KPK; dhe (iii) burimet e caktuara për ANJF-në (shih Udhëzimet për mbledhjen dhe analizën e të dhënave, faqet 17-18).
- Më poshtë është paraqitur më shumë informacion në lidhje me buxhetin për gjykata, buxhetin për prokurorinë dhe buxhetin për ndihmë juridike.
- **Pjesa më e madhe e buxhetit zyrtar për sistemin e drejtësisë u ndahet gjykatave, pastaj vijë shërbimet e prokurorisë publike dhe një shumë më e vogël i ndahet ndihmës juridike.**
- Buxheti i prokurorisë publike është rritur midis vitit 2014 dhe 2020, si vlerë nominale e po ashtu edhe me pjesën e saj në buxhetin e sistemit gjyqësor (32% e buxhetit të sistemit të drejtësisë në 2020).
- Ka dallime midis shifrave të miratuara dhe ato të realizuara për kategoritë përkatëse të buxhetit. Të dhënat e vitit 2020 flasin për nën-shpenzime në të tri kategoritë buxhetore.
- Kosova, ashtu si vendet/subjektet fqinje, përfiton nga burime të jashtme shtesë të cilat nuk bëjnë pjesë në buxhetin zyrtar, dhe nuk paraqiten në statistika. Ngjashëm, shifrat e parashikuara për vitet 2017, 2018 dhe 2020 nuk i përfshijnë të gjitha burimet buxhetore të shfrytëzuara në fushën e drejtësisë.



## 2.2. Buxheti për gjykatat


**Tabele: Buxheti vjetor i gjykatave (P6)**


Buxheti I miratuar (vlera absolute)								
	Totali	Paga bruto	Kompjuterizimi	Shpenzimet e drejtësisë	Ndërtesa (mirëmbajtje)	Ndërtesa të reja	Trajnime	Të tjera
Kosova 2014	19,431,805 €	13,792,246 €	178,612 €	NA	NA	NA	NA	NA
Kosova 2017	20,864,894 €	16,464,561 €	300,000 €	210,000 €	310,000 €	250,000 €	14,900 €	NA
Kosova 2018	26,656,957 €	22,476,781 €	95,000 €	222,000 €	170,000 €	630,000 €	19,650 €	NA
Kosova 2020	27,265,668 €	23,549,021 €	310,000 €	253,300 €	115,476 €	256,800 €	32,000 €	NA


Buxheti I zbatuar (vlera absolute)								
	Totali	Paga bruto	Kompjuterizimi	Shpenzimet e drejtësisë	Ndërtesa (mirëmbajtje)	Ndërtesa të reja	Trajnime	Të tjera
Kosova 2014	18,230,066 €	12,469,068 €	172,382 €	NA	NA	NA	NA	NA
Kosova 2017	18,558,891 €	14,622,640 €	269,536 €	193,862 €	309,327 €	35,080 €	8,466 €	NA
Kosova 2018	26,596,256 €	22,476,229 €	0.00 €	211,181 €	169,774 €	325,356 €	8,399 €	NA
Kosova 2020	26,283,996 €	23,257,862 €	144,526 €	252,459 €	115,476 €	232,369 €	11,835 €	NA

Buxheti i gjykatave/per banor	2014	2017	2018	2020
Miratuar	10.5	11.60 €	14.85 €	15.16 €
Zbatuar	9.8 €	10.3 €	15 €	14.62 €







- Bazuar në definicionet e CEPEJ-it, buxheti për gjykata është buxheti i KGJK-së pa ndihmë juridike. Buxheti fillestar i miratuar për KGJK-në ishte 29,821,540.00 EUR. Është ulur në 28,085,668.36 EUR gjatë vitit 2020. Shuma e treguar në tabelën dhe grafikun e mësipërm është buxheti përfundimtar i miratuar i KGJK-së pa ndihmë juridike (820,000.00 EUR), përkatësisht: 27,265,668 EUR. Pavarësisht rënies për shkak të COVID, **buxheti i miratuar** në vitin 2020 mbeti më i lartë se në vitin 2018.
- Buxheti i miratuar në vitin 2020 nuk mund të shpenzohej tërësisht. Shuma e shpenzuar ishte më e ulët se në vitin 2018. **Buxheti i zbatuar** për banorë ishte më i ulët se në vitin 2018 (14.62 euro në vitin 2020).
- 144,526.25 € janë shpenzuar për mirëmbajtjen e sistemit të IT-se; 252,459.82 € janë shpenzuar për ekspertë dhe gjyqtarë porotë. 232,368.74 €: Kjo shumë është shpenzuar vetëm për ndërtimin e Gjykata Themelore në Fushë Kosovë, ndërsa për shkak të mungesës së lokacioneve nuk kanë filluar projektet për Gjykata Themelore në Prizren dhe Gjykata Themelore në Mitrovicë. 11,835.00 €: Kjo pagesë ka të bëjë me trajnimet e zyrtarëve të IT-së.



- Në vitin 2020, si në vitet e mëparshme, pjesa më e madhe e burimeve buxhetore u ndanë për paga: 79% në vitin 2017, 85% në vitin 2018, dhe 97% në vitin 2020 (23,257,862EUR nga 26,283,996EUR).

### 2.3. Buxheti për prokurorinë publike



Bazuar në përcaktimet e CEPEJ-it, buxheti i prokurorisë është buxheti i KPK-së pa ndihmë juridike. Ashtu si buxheti i KGJK-së, edhe buxheti fillestar i miratuar i KPK-së është ulur në vitin 2020 për shkak të krizës së

COVID-19, nga 15,021,835 euro në 13,672,561.46 euro. Shuma e treguar në tabelat dhe grafikët e mësipërm për buxhetin e miratuar është pa ndihmë juridike (420,976,50 euro), përkatësisht: 13,251,585 euro. Pavarësisht rënies për shkak të COVID, **buxheti i miratuar** i prokurorive në vitin 2020 ka mbetur më i lartë se në vitin 2018.

- Buxheti i miratuar në vitin 2020 nuk ka mundur të shpenzohet tërësisht, por ishte më i larta se vitet e mëparshme. Në vitin 2014, **buxheti i zbatuar** për prokurorinë publike në Kosovë ishte 3.2 € për kokë banori, në vitin 2017, 4.3 € për kokë banori, në vitin 2018, 6.5€ për kokë banori, dhe 7.37 € në 2020.
- Përgjatë katër viteve, buxhetet përkatëse për prokurorinë publike nuk ishin shpenzuar plotësisht. Dallimet midis shumës së miratuar dhe asaj të realizuar u theksuan më shumë në vitin 2014 dhe 2017 dhe më pak në vitin 2018 dhe 2020.

## 2.4. Buxheti për ndihmën juridike

Buxheti i miratuar (vlera absolute)				Raste Penale			Raste tjera nga penale		
	Totali	Ne gjykate	Jashte gjykate	Totali	Ne gjykate	Jashte gjykate	Totali	Ne gjykate	Jashte gjykate
Kosova 2014	930,303 €	650,570 €	279,733 €	734,453 €	600,000 €	134,453 €	195,850 €	50,570 €	145,280 €
Kosova 2017	1,378,154 €	1,001,938 €	376,215 €	1,128,396 €	929,054 €	199,341 €	249,758 €	72,884 €	176,874 €
Kosova 2018	1,786,752 €	1,102,783 €	683,969 €	1,524,180 €	1,025,000 €	499,180 €	262,572 €	77,783 €	184,789 €
Kosova 2020	1,523,373 €	929,345 €	594,028 €	1,240,977 €	820,000 €	420,977 €	282,396 €	109,345 €	173,051 €


Buxheti i zbatuar (vlera absolute)				Raste Penale			Raste tjera nga penale		
	Totali	Ne gjykate	Jashte gjykate	Totali	Ne gjykate	Jashte gjykate	Totali	Ne gjykate	Jashte gjykate
Kosova 2014	1,076,321 €	664,705 €	411,616 €	866,956 €	600,620 €	266,336 €	209,365 €	64,085 €	145,280 €
Kosova 2017	1,749,628 €	1,116,536 €	633,091 €	902,238 €	1,043,652 €	456,217 €	249,758 €	72,884 €	176,874 €
Kosova 2018	1,775,811 €	1,091,842 €	683,969 €	1,513,239 €	1,014,059 €	499,180 €	262,572 €	77,783 €	184,789 €
Kosova 2020	1,443,569 €	851,040 €	592,529 €	1,170,866 €	796,513 €	374,353 €	€ 272,704	€ 54,528	€ 218,176

● Si një shënim të hershëm, duhet të kujtoni se si llogaritej buxheti për ndihmë juridike bazuar në metodologjinë CEPEJ: Nuk ka **asnjë buxhet të vetëm për ndihmë juridike** në Kosovë, sepse gjykatat dhe Z-NJF të dyja janë të përfshirë në dhënien e ndihmës juridike falas. Për më tepër, kur emërohet një avokat falas gjatë fazës paraprake të procedurës penale, shpenzimet mbulohen nga buxheti i KPK-së. Shuma totale e buxhetit të miratuar të raportuar për qëllimin e këtij studimi është marrë pra duke mbledhur burimet e ndryshme, dhe atë: (i) burimet e caktuara në buxhetet e KGJK-së dhe (ii) KPK-së për ndihmë juridike (të shfrytëzuar ekskluzivisht për lëndë penale), dhe (ii) burimet e caktuara për Z-NJF (kryesisht të shfrytëzuara për lëndë të tjera jo penale).


1. **Burimet e caktuara në buxhetet e KGJK-së:** 820,000.00 EUR;
2. **Burimet e caktuara në buxhetet e KPK-së:** KPK nuk ka linjën buxhetore të miratuar për avokatët. Linja buxhetore është për avokatë dhe ekspertë: "Shërbimet e sipërfaqesimit". Totali i aprovuar për këtë kategori ka qenë 841,953EUR. Kjo shumë u nda në dy, për avokatë dhe për ekspertë (420,976.50 euro).
3. **Burimet e caktuara për Z-NJF:** Vini re se, bazuar në përkufizimin e CEPEJ për "ndihmë juridike", shuma e treguar këtu për buxhetin e miratuar të ndihmës juridike të Agjencisë së Ndihmës Juridike Falas (përkatësisht: 282,396 EUR) nuk është i gjithë buxheti i Agjencisë. Nuk janë përfshirë "Shpenzimet komunale" në buxhetin e Agjencisë (shih Udhëzimet për mbledhjen dhe analizën e të dhënave, faqe 19). I gjithë buxheti i Agjencisë për Ndihmë Juridike Falas, i aprovuar fillimisht në vitin 2020 ishte 422,698,99 euro. Për shkak të krizës së COVID-19, u ul në 307,393.84 euro.

- Kur i shikojmë këto tre burime së bashku, shohim se **buxheti i ndihmës juridike u rrit në mënyrë të konsiderueshme në mes të viteve 2014 dhe 2018 por u ul në vitet 2018 dhe 2020.**
- Grafiku më poshtë tregon evolucionin e burimeve të caktuara për ndihmë juridike në tri

institucionet përkatëse: KGJK, KPK dhe NJF. Buxheti i KGJK-së për ndihmë juridike është ulur nga rreth 1,000,000 euro në 820,000 euro. Buxheti i KPK-së për ndihmë juridike është ulur gjithashtu nga rreth 500,000 euro në 420,000 euro. Buxheti i Agjencisë së Ndihmës Juridike Falas është rritur lehtë. Megjithatë, buxheti i Ndihmës Juridike Falas mbetet i vogël në krahasim me buxhetin për ndihmë juridike të KGJK-së dhe KPK-së.



- Në mes të viteve 2014 dhe 2018, buxheti i përgjithshëm i zbatuar për ndihmë juridike u rrit. Megjithatë, nga viti 2018 deri në vitin 2020, buxheti i realizuar për ndihmë juridike ka rënë. Agjencia e Ndihmës Juridike Falas zbatoi vetëm gjysmën e buxhetit të saj për avokatët (miratuar: 109,345 EUR dhe zbatuar: 54,528 EUR).



## 2.5. Zhvillimet në gjendjen e teknologjisë së informacionit (TI)

● Pyetësi i CEPEJ përmban pyetje në lidhje me disponueshmërinë e TI në gjykata. Projekti KoSEJ ka bërë një vlerësim bazuar në këtë pyetësor dhe pyetjet specifike për TI. Raporti shikon tre kategori të mjeteve të TI-së, të cilat më pas mundësojnë llogaritjen e indeksit të përgjithshëm të vendosjes së IT (shkalla 0-10):

- i. Teknologjitë e mbështetjes së hartimit të vendimeve të cilat përfshijnë bazat e të dhënave të vendimeve gjyqësore, ekzistencën e një regjistrimi kombëtar të dënimeve penale, mjetet e ndihmës për shkrimin dhe regjistrimin e zërit duke përfshirë veçoritë e njohjes së zërit;
- ii. Sistemet e menaxhimit të gjykatave dhe lëndëve, të cilat përfshijnë sistemet e menaxhimit të lëndëve (përfshirë ndërveprueshmërinë e tyre, funksionet e menaxhimit aktiv të çështjeve dhe statistikave), sistemet e menaxhimit buxhetor dhe financiar të gjykatave, si dhe mjetet e vlerësimit të ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit administrativ;
- iii. Komunikimi ndërmjet gjykatave, profesionistëve dhe/ose përdoruesve të gjykatës, që përfshin mundësinë e paraqitjes së një çështjeje në mënyrë elektronike, realizimin e shkëmbimit të komunikimit brenda fazave të ndryshme të një çështjeje ndërmjet gjykatës, palëve, avokatëve dhe profesionistëve të tjerë, ekzistencën e procedurave të specializuara online, videokonferenca dhe regjistrimi i seancave.

Indeksi i përgjithshëm i vendosjes së TI-së për Kosovën në vitin 2020 ishte 3,23 nga 10.

### 3. PROFESIONISTËT

#### 3.1. Gjyqtarë profesionistë

- Vlerësimi i situatës në lidhje me gjyqtarët profesionistë të punësuar në sistemin gjyqësor në Kosovë u nënshtrohet disa specifikimeve metodologjike. Si kujtesë, përkufizimi i 'gjyqtarëve profesionistë' sipas metodologjisë CEPEJ thekson se "kur një gjyqtar është i punësuar me gjysmë orari, puna e tij/saj duhet të shndërrohet në **ekuivalent me kohë të plotë (FTE)** dhe do të llogaritet si e tillë në shifrat e përgjithshme (p.sh. 0,5 FTE për një gjyqtar që punon gjysmë dite)".
- Duhet të theksohet se numrat e raportuar për katër vitet **nuk i referohet numrit ekuivalent të orarit të plotë (FTE), por numrit absolut të gjyqtarëve me pozita të përhershme**. Për më tepër, pasi që shifrat e raportuara nuk përmbajnë vetëm ata gjyqtarë që trajtojnë në mënyrë aktive lëndët, ato janë më të larta se ato efektive - kjo ndikon në analizën e performancës së gjykatave (por jo edhe analizën e mjeteve buxhetore).

	Totali			Shkalla 1			Shkalla 2			Shkalla 3		
	Totali	Burra	Gra	Totali	Burra	Gra	Totali	Burra	Gra	Totali	Burra	Gra
Kosova 2014	317	227	90	271	196	75	32	22	10	14	9	5
Kosova 2017	399	272	127	347	234	113	40	30	10	12	8	4
Kosova 2018	416	286	130	358	244	114	42	31	11	16	11	5
Kosova 2020	391	260	131	332	218	114	45	33	12	14	9	5

per 100,000 banore


	Totali			Shkalla 1			Shkalla 2			Shkalla 3		
	Totali	Burra	Gra	Totali	Burra	Gra	Totali	Burra	Gra	Totali	Burra	Gra
Kosova 2014	17.1	12.3	6.9	14.6	10.6	4.0	1.7	1.2	0.5	0.8	0.5	0.3
Kosova 2017	22.2	15.1	7.1	19.3	13.0	6.3	2.2	1.7	0.6	0.7	0.4	0.2
Kosova 2018	23.2	15.9	7.2	19.9	13.6	6.3	2.3	1.7	0.6	0.9	0.6	0.3
Kosova 2020	21.7	14.5	7.3	18.5	12.1	6.3	2.5	1.8	0.7	0.8	0.5	0.3

- Në mes të viteve 2014 dhe 2018 numri i përgjithshëm për gjyqtarë profesionistë është rritur për 31,2%. Në vitin 2014, gjykatat në Kosovë kanë pasur të punësuar 17.1 gjyqtarë për 100,000 banorë; numri u rrit në 22.2 gjyqtarë për 100,000 banorë në vitin 2017 dhe 23.2 gjyqtarë për 100,000 banorë në vitin 2018.
- Megjithatë, **mes viteve 2018 dhe 2020, numri i gjyqtarëve është ulur**. Numri i gjyqtarëve për banorë në vitin 2020 ka qenë më i ulët se numri i gjyqtarëve për banorë në vitin 2017, përkatësisht: 21.7 gjyqtarë për banorë në vitin 2020 krahasuar me 22.2 në 2017.
- KGJK raportoi se gjatë vitit 2017, 47 nga 347 gjyqtarë të punësuar në shkallë të parë kanë marrë pjesë në **trajnimin e detyrueshëm të Akademisë së Drejtësisë të Kosovës**, kështu që ata nuk kanë proceduar asnjë lëndë. Në vitin 2018, 52 nga 358 gjyqtarët në shkallë të parë kanë marrë pjesë në këtë trajnim dhe nuk kanë proceduar asnjë lëndë. **Në prill të vitit 2019, situata ndryshoi: KGJK-ja vendosi që gjyqtarët e rinj do të lejohen të trajtojnë lëndët dhe do të marrin një të tretën e lëndëve që marrin gjyqtarët e tjerë, pasi që ata duhet të ndjekin seancat e trajnimit në Akademi dy ditë në javë.**<sup>3</sup> Akademia shpjegoi se trajnimi filloi më 11 mars 2019 dhe përfundoi më 24 qershor 2020 (u vonua pak për shkak të situatës pandemike). Gjenerata e ardhshme e gjyqtarëve (gjenerata e tetë) filloi më 18 shkurt 2021. Në total, në vitin 2020, deri më 24 qershor, 37 gjyqtarët e rinj (të cilët filluan trajnimin në mars 2019) punonin vetëm 30%. Më pas ata filluan të punojnë me kohë të plotë. Prandaj, është e vështirë të dihet numri i gjyqtarëve FTE për vitin 2020. Ka qenë më pak se 332 para datës 24 qershor 2020. Ky numër është më i lartë se numri i viteve të mëparshme. Në vitin 2018, nëse heqim gjyqtarët që kryenin trajnimin në


<sup>3</sup> Shihni vendimin e KGJK-së këtu: [https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/74144\\_KGJK\\_Vendimi\\_Nr-84\\_05\\_04\\_2019.pdf](https://www.gjyqesori-rks.org/wp-content/uploads/decisions/74144_KGJK_Vendimi_Nr-84_05_04_2019.pdf)




Akademi (dhe për rrjedhojë nuk trajtonin çështjet në gjykata), ishin vetëm 306 gjyqtarë.



- Mbledhja dhe raportimi i numrave FTE është pra thelbësor, sepse shifrat jo FTE tregojnë në mënyrë jo të saktë se ngarkesa me lëndë është duke u trajtuar nga një numër gjyqtarësh më shumë se numri real në praktikë.



- Përqindja e gjyqtarëve në Gjykatën e Apelit është rritur në vitin 2020 (12%).




- Vlerësimi i vitit 2014 tregoi se përqindja e gjyqtareve femra të gjykatave në Kosovë ishte më e ulëta në mesin e shteteve anëtare/subjekteve të Këshillit të Evropës të përfshira në atë ushtrim (28% gjyqtare femra). **Në vitin 2020 përqindja e gjyqtareve femra (34%) ishte më e lartë se në vitet paraprake.** Në vitin 2020, prej 391 gjyqtarëve, 131 ishin gra. Kjo mbetet e ulët në krahasim me numrin e meshkujve: 260.

#### Numri i kryetareve


	Totali		
	Totali	Burra	Gra
<b>Kosova 2014</b>	9	7	2
<b>Kosova 2017</b>	9	8	1
<b>Kosova 2018</b>	9	8	1
<b>Kosova 2020</b>	9	8	1

- Të dhënat tregojnë se **nuk ka përparim në lidhje me përfaqësimin e gjyqtareve femra në mesin e kryetarëve të gjykatave.** Në të katër vlerësimet, në pozitat e kryetarëve të Gjykatës së Apelit dhe Gjykatës Supreme ishin gjyqtarë meshkuj.

### 3.2. Staf i jo-gjyqtarë




- Numri i përgjithshëm i stafit jo-gjyqtar është rritur midis viteve 2014 dhe 2018. Në vitin 2018, gjykatat në Kosovë kishin të punësuar 246 persona më shumë sesa në vitin 2014. Megjithatë, **mes 2018 dhe 2020, numri i stafit jo-gjyqtar u ul.**
- Në mesin e stafit jo-gjyqtar, midis viteve 2014 dhe 2018, numri i stafit që ndihmonte drejtpërdrejt gjyqtarët u rrit nga 391 në 427 (36 persona më shumë). Ky numër u rrit ndjeshëm midis 2018 dhe 2020: nga 427 në 587 staf. Në këtë kategori bëjnë pjesë stafi nga gjykatat: bashkëpunëtorët profesional (137), zyrtarët ligjorë (439) dhe zyrtarët e lartë ligjorë (5), si dhe këshilltarët profesionistë (6).
- **Numri i personelit që ndihmon drejtpërdrejt gjyqtarët është rritur, ndërsa ai administrativ është ulur.** Kjo për shkak se një numër i madh i stafit administrativ (të cilët kishin përvojën e kërkuar) u rekrutuan si zyrtarë ligjorë ose bashkëpunëtorë profesional. Pozicionet e këtyre stafit administrativ nuk u rishpallën. Numri i personelit administrativ ka rënë nga 678 në 443, që është numri më i ulët që nga viti 2014.
- Numri i stafit teknik ka ardhur duke u rritur ngadalë që nga viti 2014. Ai u rrit midis 2018 dhe 2020 sepse numri i stafit të IT-së u rrit.



- Numri i stafit për gjyqtar u ul nga 4.21 në vitin 2014, në 3.87 në vitin 2017, dhe në 3.80 në vitin 2018. U rrit lehtësisht mes 2018 dhe 2020, në 3.89.

### 3.3. Prokurorët




- Gjatë viteve 2014, 2017 dhe 2018 numri i përgjithshëm i prokurorëve publikë u rrit nga 139 në vitin 2014 në 191 në vitin 2018 (37%). Këta numra ishin numra absolut dhe jo numra FTE (që do të thotë se në vitin 2018, për shembull, në mesin e 191 prokurorëve, disa prej tyre nuk i trajtuan çështjet për shkak të pushimit apo funksioneve shtesë).

- **Në vitin 2020, numri absolut i prokurorëve ishte 190, që ishte afërsisht i njëjti numër me vitin 2018. Sidoqoftë, në tablën e mësipërme për vitin 2020 është vendosur numri i prokurorëve FTE: 175.** Pra, 15 prokurorë të cilët mbajnë pozita dhe kanë detyra tjera të caktuara në sistemin e drejtësisë e të cilët nuk merren me hetimin e rasteve: Kryesuesi i Keshillit, Kryeprokurori i Shtetit, zëvendës Kryesuesi i Keshillit, Kryesuesi i komisionit për ceshtje normative, Kryesuesi i Komisionit për administrimin e prokurorive, kryesuesi i Komisionit për vleresim të performancës së prokurorëve, kryeprokurori i prokurorisë së apelit, kryeprokurori i prokurorisë speciale dhe kryeprokuroret e 7 prokurorisë themelore.


	2014	2017	2018	2020
Nr i prokurorëve për 100000 banorë	7.5	9.8	10.6	9.7

- Në vitin 2014, për 100,000 banorë kanë qenë të punësuar 7.5 prokurorë; numri u rrit në 9.8 prokurorë për 100,000 banorë në vitin 2017 dhe 10.6 prokurorë për 100,000 banorë në vitin 2018. Në vitin 2020 numri i prokurorëve për 100,000 banorë është 9.7. Duhet të theksohet edhe një herë, se viteve paraprake të dhënat nuk janë të ndara në FTE, andaj numri mund të shihet që ka një rënie të vogël por në fakt nuk është rënie por dallim mes llojit të të dhënave të mbledhura në vitet paraprake.




- Në vitin 2017 dhe 2018 përqindja e prokurorëve femra (40%) ishte më e lartë se në vitin 2014 (36%). **Në vitin 2020, përqindja vazhdoi të rritet dhe arriti në 44%. Megjithatë, në vitin 2020 nuk kishte ende gra si kryeprokurore në asnjë nga prokuroritë.**

### 3.4. Stafi jo-prokurorë



- Stafi që mbështet prokurorët publikë dhe prokuroritë publike është rritur nga 423 në vitin 2014, në 477 në vitin 2017, në 567 në vitin 2018, dhe në **613 në vitin 2020**.





- Kur shikojmë nëse rritja e numrit të stafit të punësuar nga shërbimi i prokurorisë është në përpjesëtim me rritjen e numrit të prokurorëve, të dhënat tregojnë se ndihma e ofruar për prokurorët publikë është ulur në vitin 2017 (nga 3.1 në 2014 në 2.7 anëtarë të stafit për prokuror) dhe u rrit përsëri në vitin 2018 dhe 2020 (3.2 punonjës për prokuror në vitin 2020).
- Këto të dhëna janë të rëndësishme për analizën e efikasitetit të shërbimit të prokurorisë publike në përgjithësi.

### 3.5. Pagat e gjyqtarëve dhe prokurorëve

Paga për gjyqtarët				
Column1	2014	2017	2018	2020
Paga bruto ne fillim karriere	€ 10,992.00	€ 10,992.00	€ 20,071.80	€ 22,939.20
Paga bruto ne gjykatën e larte	€ 15,252.00	€ 15,252.00	€ 31,860.00	€ 31,860.00
Paga bruto ne fillim karriere (v. pagën mesatare)	2.3	2.1	3.7	4.1
Paga bruto ne gjykatën e larte (v. pagën mesatare)	3.2	2.9	5.9	5.7


Paga për prokurorët				
Column1	2014	2017	2018	2020
Paga bruto ne fillim karriere	€ 12,612.00	€ 12,612.00	€ 22,939.20	€ 22,939.00
Paga bruto ne shkallën e larte	€ 15,576.00	€ 16,378.68	€ 32,260.00	€ 31,860.00
Paga bruto ne fillim karriere (v. pagën mesatare)	2.6	2.4	4.2	4.1
Paga bruto ne shkallën e larte (v. pagën mesatare)	3.2	3.2	5.9	5.7



- Kjo bazohet në Ligjin Nr. 06/L-054 për Gjykatat. Në vitin 2018 prokurorët kanë marrë para shtesë për rrezikshmëri.

- Në vitin 2020 gjyqtarët dhe prokurorët ishin paguan 4 herë më shumë se paga mesatare bruto (PMB) në fillim të karrierës së tyre.

### 3.6. Avokatët



- Në të katër vlerësimet, numri i avokatëve dhe numri për 100,000 banorë **është rritur**. Përderisa numri total i avokatëve në vitin 2014 ka qenë 703, ky numër është rritur në 1111 në vitin 2020.
- Numri i avokatëve femra **është rritur** nga viti 2016 si më poshtë:





## 4. EFIKASITETI I VEPRIMTARISË SË GJYKATAVE DHE PROKURORIVE

Dy treguesit kryesorë të CEPEJ janë si më poshtë:

### **NORMA E ZGJIDHJES SË LËNDËVE (CR)**

Raporti i përfituar nga pjesëtimi i numrit të lëndëve të zgjidhura me numrin e lëndëve të pranuar në një periudhë të caktuar, e shprehur si përqindje:

$$\text{Norma e zgjidhjes së lëndëve (\%)} = \frac{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura në një periudhë kohore}}{\text{Numri i lëndëve të pranuar në një periudhë kohore}} \times 100$$

Norma e zgjidhjes së lëndëve e barabartë me 100% tregon aftësinë e gjykatës ose të një sistemi gjyqësor për të zgjidhur aq lëndë sa është numri i lëndëve të pranuar brenda periudhës së caktuar kohore. Një normë e zgjidhjes së lëndëve mbi 100% tregon aftësinë e sistemit për të zgjidhur më shumë lëndë sesa ato të pranuar. Përfundimisht, një normë e zgjidhjes së lëndëve nën 100% shfaqet kur numri i lëndëve të pranuar është më i lartë se numri i lëndëve të zgjidhura. Në këtë rast numri i lëndëve të pazgjidhura do të rritet.

Në të vërtetë, norma e zgjidhjes së lëndëve tregon se si gjykata apo sistemi gjyqësor po përballet me rrjedhën e lëndëve të pranuar.

### **KOHA E LLOGARITUR E PËRFUNDIMIN E LËNDËVE TË PAZGJIDHURA (DT)**

Numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të një viti, i ndarë me numrin e lëndëve të zgjidhura brenda atij viti, shumëzuar me 365 (ditët e një viti):

$$\text{Koha e llogaritur për përfundimin e lëndëve të pazgjidhura} = \frac{\text{Numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit}}{\text{Numri i lëndëve të zgjidhura brenda vitit}} \times 365$$

Ky tregues vlerëson se sa ditë duhet të kërkohen për të zgjidhur lëndët e pazgjidhura bazuar në kapacitetin aktual të gjykatës për të zgjidhur lëndët. Ajo përdoret si një parashikim i kohëzgjatjes së procedurave gjyqësore.

Ky tregues nuk është llogaritje e kohëzgjatjes së procedurave, por është vlerësim teorik i kohës së nevojshme për të proceduar lëndët e pazgjidhura.

#### 4.1. Lëndët civile dhe ekonomike në procedure kontestimore: ngarkesa me lëndë dhe treguesit e performancës


- Në këtë kategori përfshihen lëndët që në Kosovë u referohen si "lëndë civile në procedurë kontestimore" dhe "lëndë ekonomike ose tregtare" (lëndë në procedurë jo-kontestimore nuk janë përfshirë).

#### P91, P97, P99: Lëndët civile / ekonomike (nr. absolut)

Civile	Shkalla 1					
	Të pazgjidhura ne fillim (1.1.XXXX)	Të pranuar	Të zgjidhura	Të pazgjidhura në fund (31.12.XXX X)	CR (%)	DT (dite)
<b>Kosova (2014)</b>	45997	16731	18656	44072	111.5%	862
<b>Kosova (2017)</b>	41710	18381	17600	42491	95.8%	881
<b>Kosova (2018)</b>	42496	20268	17465	45299	86.2%	947
<b>Kosova (2020)</b>	56748	30044	20905	65887	69.6%	1150


Civile	Shkalla 2					
	Të pazgjidhura ne fillim (1.1.XXXX)	Të pranuar	Të zgjidhura	Të pazgjidhura në fund (31.12.XXX X)	CR (%)	DT (dite)
<b>Kosova (2014)</b>	5986	5215	4219	6982	80.9%	604
<b>Kosova (2017)</b>	10109	6205	4649	11665	74.9%	916
<b>Kosova (2018)</b>	11665	6027	5698	11994	94.5%	768
<b>Kosova (2020)</b>	10328	6857	7907	9278	115.3%	428



Në mesin e viteve 2014 dhe 2020 tendencat e evolucionit të normës së zgjidhjes së lëndëve (CR) civile dhe ekonomike në secilën shkallë ndryshojnë. Në këtë kategori përfshihen lëndët që në Kosovë u referohen si “lëndë civile në procedurë kontestimore” dhe “lëndë ekonomike ose tregtare” (lëndë në procedurë jo-kontestimore” nuk janë përfshirë).


- **Në shkallën e parë ka pasur përkeqësim progresiv të normës së zgjidhjes së lëndëve për këtë kategori lëndësh (nga 112% në vitin 2014, 86% në vitin 2018 në 70% në vitin 2020).** Kjo mund t'i atribuohet efektit të rritjes së numrit të lëndëve të pranura gjatë periudhës së vlerësimit (Gjykatat e shkallës së parë kanë pranuar pothuajse 10,000 lëndë midis 2018 dhe 2020). KGJK njofton se gjatë vitit 2020 është pranuar një numër i madh i lëndëve që kanë pasur objekt kontesti shujtat dhe pagat jubilarë dhe për shkak të një paqartësie ligjore dhe praktike të shkaktuar nuk është arritur të trajtohen këto lëndë gjë që ka rezultuar në këtë CR.

- Si rezultat, numri i lëndëve të pazgjidhura në fund të vitit 2018 u rrit në 45,299 dhe kjo rritje vijoi edhe në vitin 2020 ku u grumbulluan 65,887 lëndë të pazgjidhura.



- Në vitin 2020, falë SMIL-it, Departamenti i Statistikave të KGJK-së ka mundur të ofrojë të dhëna të cilat nuk ishin të disponueshme vitet e kaluara, për moshën e lëndëve të pazgjidhura. **Në vitin 2020, 37% e lëndëve civile dhe ekonomike ishin më të vjetra se 2 vjet (përkatësisht: 24,273 çështje nga 65,887).**
- Në nivelin e Gjykatës së Apelit, CR e lëndëve civile dhe ekonomike u ul në mes të viteve 2014 dhe 2017 (nga 81% në 75%) por u rrit përsëri përtej pragut të vitit 2014 në vitin 2018 (95%). Trendi i rritjes së CR së lëndëve civile dhe ekonomike në Gjykatën e Apelit vijoi edhe në vitin 2020 duke arritur në 115%. Kjo rritje e CR rezultoi edhe në zvogëlimin e lëndëve të pazgjidhura civile dhe ekonomike në procedurë kontestimore pranë Gjykatës së Apelit **të bien nga 11,994 sa ishin në fund të vitit 2018 në 9,278 në fund të vitit 2020.**


### Lëndët civile dhe ekonomike në procedurë kontestimore - Gjykata e Apelit



	2014	2017	2018	2020
Lëndët e pranuar	5215	6205	6027	6857
Lëndët e zgjidhura	4219	4649	5698	7907
Lëndët e pazgjidhura	6982	11665	11994	9278

- Të dhënat e zbërthyer (lëndë civile në procedurë kontestimore dhe lëndë ekonomike) janë si më poshtë:


### CR në nivel të shkallë 1 (zbërthyer)



	Lëndë ekonomike	Lëndë civile në procedurë kontestimore
2014	63%	114%
2017	107%	95%
2018	106%	86%
2020	79%	69%


■ 2014 ■ 2017 ■ 2018 ■ 2020

## CR në nivel të shkallës 2 (zbërthyer)



	Lëndë ekonomike	Lëndë civile në procedurë kontestimore
CR in 2014	78%	137%
CR in 2017	75%	73%
CR in 2018	96%	70%
CR in 2020	167%	113%

- Vlerësimi i zbërthyer i normës së zgjidhjes së lëndëve në këtë kategori të lëndëve (lëndë civile dhe ekonomike) tregon se:
  - gjykatat e shkallës së parë në vitin 2018 janë përballur me vështirësi vetëm në lëndët civile - dhe jo me lëndët ekonomike (CR 86% për lëndët civile; CR 106% për lëndët ekonomike) kurse në vitin 2020 shihet një nivel i përafërt i vështirësisë **në lëndët ekonomike me CR prej 79% dhe lëndët civile me 69%.**
  - gjykata e apelit në vitin 2018 u përball me vështirësi si me lëndët civile ashtu edhe me ato ekonomike (CR 96% për lëndët civile; 70% CR për lëndët ekonomike), **mirëpo në vitin 2020 ka pasur një progres të madh edhe në lëndët civile me një rritje në 113% e po ashtu edhe në lëndët ekonomike me 167%.**



- Koha e llogaritur për përfundimin e lëndëve të pazgjidhura (DT), përkatësisht koha e nevojshme për të zgjidhur lëndët civile dhe ekonomike e pazgjidhura, **është rritur në shkallë të parë: nga 862 ditë në vitin 2014, 947 ditë në vitin 2018 në 1150 ditë në vitin 2020.** Kjo është në përputhje me përkeqësimin e vazhdueshëm të CR-së gjatë vlerësimeve.
- Në shkallën e dytë, ka një ndryshim të DT përgjatë viteve, ku fillon nga 604 ditë në vitin 2014, rritet në 768 ditë në vitin 2018 dhe zvogëlohet në 428 ditë në vitin 2020. Andaj, **viti 2020 shihet si një përmirësim i dukshëm** i situatës krahasur me të gjitha vitet paraprake, siç tregohet më lart.


#### 4.2. Lëndët administrative: ngarkesa me lëndë dhe treguesit e performancës

- Lëndët që në Kosovë, u referohen si “Lëndë administrative” (në të gjitha shkallët) përfshihen pikërisht në këtë kategori.

<b>P91, P97, P99: Lëndë Administrative (numri absolut)</b>						
<b>Administrative</b>	<b>Shkalla 1</b>					
	<i>Të pazgjidhura ne fillim (1.1.XXXX)</i>	<i>Të pranuar</i>	<i>Të zgjidhura</i>	<i>Të pazgjidhura në fund (31.12.XXXX)</i>	<i>CR (%)</i>	<i>DT (dite)</i>
<b>Kosova (2014)</b>	2061	2568	1130	4039	44.0%	1305
<b>Kosova (2017)</b>	5192	2380	2268	5304	95.3%	854
<b>Kosova (2018)</b>	5304	3008	2219	6093	73.8%	1002
<b>Kosova (2020)</b>	6380	1905	1947	6338	102.2%	1188
<b>Administrative</b>	<b>Shkalla 2</b>					
	<i>Të pazgjidhura ne fillim (1.1.XXXX)</i>	<i>Të pranuar</i>	<i>Të zgjidhura</i>	<i>Të pazgjidhura në fund (31.12.XXXX)</i>	<i>CR (%)</i>	<i>DT (dite)</i>
<b>Kosova (2014)</b>	271	494	376	389	76.1%	378
<b>Kosova (2017)</b>	334	556	472	418	84.9%	323
<b>Kosova (2018)</b>	418	665	748	335	112.5%	163
<b>Kosova (2020)</b>	544	797	620	721	77.8%	424



### Lëndë Administrative, CR% (P91, P97, P99)




- Duhet të kujtojmë se, që nga janari 2013, Departamenti për Çështje Administrative në Gjykatën Themelore të Prishtinës ka juridiksion ekskluziv në të gjithë territorin e Kosovës për t'u marrë me lëndët kur njëra nga palët e mosmarrëveshjes është autoritet publik. Prandaj, Gjykata Themelore e Prishtinës trajton tërë vëllimin e lëndëve të pranuar në këtë sektor.

- Në shkallën e parë, norma e zgjidhjes së lëndëve të kësaj kategorie të lëndëve u rrit në mes të viteve 2014 (44%) dhe 2017 (95%), por përsëri ra në vitin 2018 (74%). Kjo mund të shpjegohet me faktin se numri i lëndëve të pranuar administrative u zvogëlua në vitin 2017 por u rrit përsëri në vitin 2018 (rreth 3000 lëndë të pranuar). Përveç kësaj, në vitin 2018, numri i lëndëve administrative të zgjidhura ishte më i ulët se në vitin paraprak. Rrjedhimisht, në fund të vitit 2018, numri i lëndëve të pazgjidhura arriti në 6000 në vitin 2018.

- Ndërsa, po në shkallën e parë, **në vitin 2020 norma e zgjidhjes së lëndëve u rrit në 102.2% duke lënë rreth 6300 lëndë të pazgjidhura në fund të 2020.** Atë vit, gjykatat kanë pranuar më pak lëndë se në vitin 2018 (1905 lëndë të pranuar në vitin 2020 krahasuar me 3008 në 2018). Gjykatat gjithashtu kanë zgjidhur më pak lëndë (1947 lëndë të zgjidhura në vitin 2020 krahasuar me 2219 në 2018). Megjithatë, CR është pozitive sepse gjykatat kanë zgjidhur pak më shumë lëndë sesa kanë marrë.

- Në shkallën e dytë, CR-ja e lëndëve administrative tregon një përmirësim të rëndësishëm, nga 85% në vitin 2017 në 112.5% në vitin 2018. **Në vitin 2020, ky trend i rritjes së CR-së ra në 77.8%** duke rritur numrin e lëndëve të pazgjidhura nga 335 sa kishin mbetur në fundin e vitit 2018 në 721 në fundin e vitit 2020.



- Koha e llogaritur për përfundimin e lëndëve administrative të pazgjidhura në vitin 2020 si në shkallën e parë ashtu edhe në atë të dytë u rrit dukshëm. Përderisa **në shkallën e parë DT u rrit nga 1,002 sa ishte në vitin 2018 në 1,188 në vitin 2020, në shkallën e dytë DT u rrit nga 163 në vitin 2018 në 424 në 2020.**


#### 4.3. Lëndët penale: ngarkesa me lëndë dhe treguesit e performancës

##### *Ngarkesa me lëndë në prokurori*

- Sa u përket shërbimeve të prokurorisë, CEPEJ mbledh të dhëna për: (1) numri i lëndëve të pranuar nga prokurorët, (2) lëndët e ndërprera nga prokurori; (3) lëndët e përfunduara me dënim ose masë të shqiptuar ose negociuar nga prokurori; dhe (4) lëndët e ngarkuara nga prokurori publik para gjykatave.

#### **P107: Numri total i lëndëve të proceduara nga prokurori publik (numri absolut)**

	Shkalla 1			
	<i>Të marra gjatë vitit referues</i>	<i>Të ndërprera gjatë vitit ref.</i>	<i>Të përfunduara me dënim ose masë e caktuar ose negociuar nga prokurori publik</i>	<i>Lëndë të paraqitura në gjykatë</i>
<b>Kosova (2018)</b>	52,945	13,138	2,447	28,527
<b>Kosova (2020)</b>	31,285	9,695	2,262	20,639



- Sikurse edhe në raportet e mëparshme, përveç kategorisë “Rastet e përfunduara me dënim ose masë të shqiptuar apo negociuar nga prokurori publik”, **KPK-ja ka ofruar të dhëna për numrin e personave të përfshirë në lëndë e jo të dhënat për numrin e vetë lëndëve, siç kërkohet në metodologjinë CEPEJ.** KPK-ja shpjegoi se këto të dhëna janë më precize. Sidoqoftë, për qëllimin e kësaj pyetjeje, CEPEJ kërkon “numër e lëndëve”, duke mbajtur të njëjtin koncept si për gjykatat. KPK sqaroi se në të ardhmen duhet të mundësohet mbledhja e këtyre të dhënave nga SMIL, për rast dhe jo vetëm për person.
- Në vitin 2020, numri i personave të përfshirë në rastet e pranuar nga prokuroritë ishte 31,285 (29,497 ne regjistrin PP me kryes madhor te njohur dhe 1,788 ne regjistrin PPM me kryes te mitur te njohur). Në vitin 2018, numri i raportuar ishte 52,945. Duket se ka një rënie të ndjeshme, por në fakt KPK sqaroi se në vitin 2018 kanë aplikuar një menyrë e raportimit tjetër në mbledhjen e të dhënave.
- Më i ulët ka qenë edhe numri i personave të përfshirë në rastet e pushuara në vitin 2020 krahasuar me vitin 2018. Në këtë numër KPK përfshin: pushimin e kallëzimeve penale, pushimin e hetimeve, pushimin e procedimeve ndaj të miturve, parimin e oportunitetit (në rastet e të miturve) dhe çështjet e mbyllura për shkak të parashkrimit.
- Numri i rasteve të përfunduara me dënim apo masë të shqiptuar apo negociuar nga prokurori ka qenë pak më i ulët në vitin 2020 se në vitin 2018. Në këtë numër KPK përfshin: të dhënat për procedurat e ndërmjetësimit dhe rastet me praninë fajësie të negociuara.
- Së fundi, numri i personave të përfshirë në çështjet e paraqitura në gjykatë ka qenë më i ulët në vitin 2020 se në vitin 2018: 20,639 persona në vitin 2020 krahasuar me 28,527 persona në vitin 2018. Në këtë kategori KPK përfshiu: aktakuza të drejtpërdrejta, aktakuza për dhënie urdhri ndëshkimor, aktakuza pas hetimi, masat e diversitetit për të miturit, masat disiplinore, masat e mbikëqyrjes së shtuar, masat institucionale, masat për trajtim të detyrueshëm, urdhrat për punë në komunitet, gjoba dhe burgim.

## Ngarkesa e gjykatës me lëndë

- Në përputhje me metodologjinë CEPEJ, të dhënat për lëndët penale përmbajnë dy nën-kategori: “vepra të rënda” dhe “vepra të lehta”.
- Në raportet e mëparshme, kategoria e CEPEJ-it “Veprat e rënda” përfshinte lëndën penale të trajtuar nga lëndën penale të trajtuar nga Departamenti për Krime të Rëndës dhe Divizioneve penale të Departamenteve të Përgjithshme. Në vitin 2020, në kategorinë e CEPEJ-it të “Veprat e rënda” janë përfshirë edhe një lloj tjetër lëndësh, konkretisht: **lëndët nga Departamenti Special**, që është një departament i ri.<sup>4</sup>
- “Veprat e lehta” përfshijnë rastet e trajtuara nga Divizioni i kundërvajtjeve në Departamentin e Përgjithshëm dhe Departamenti për të Mitur (sepse në këto raste nuk ka rrezik burgimi, duke përjashtuar rastet jashtëzakonisht të rralla).
- Nëse i shohim rastet në ardhje për “Veprat e rënda” dhe “Veprat e lehtëve” të marra së bashku (tabela më poshtë “P94, P98, P100: Lëndë penale të rënda (numri absolut)” dhe tabelën “P94, P98, P100: Lëndë të lehta (numri absolut)” faqe 37), shohim si vijon: Në vitin 2014, veprat e rënda përbënin 6.1% të të gjitha lëndëve penale që paraqiten në gjykatë (19,790 nga 324,194 lëndë). Kjo për shkak se numri i “Veprave të lehta” në ardhje ishte shumë i lartë (rreth 300.000 raste). Në vitin 2017, ato përbënin 16.4% të të gjitha lëndëve penale të pranuar (26,797 nga 162,914 lëndë) dhe në vitin 2018, një pjesë e tillë u rrit në 40.2% të të gjitha lëndëve penale të pranuar (23,640 nga 58.746 lëndë) për shkak se numri i “Veprat e lehta” në hyrje është zvogëluar dukshëm që nga viti 2014 (rreth 35,000 raste). Së fundi, **në 2020, veprat e rënda penale përbënin 39.6% të lëndëve penale që paraqiten në gjykatë (16,996 nga 42,887 lëndë).**
- Analiza e të dhënave për secilën nën-kategori paraqet një perspektivë më të qartë të punës së gjykatave në këtë fushë.


## Kategoria e CEPEJ “Veprat e rënda”

### P94, P98, P100: Lëndë penale të rënda (numri absolut)



Penale	Shkalla 1					
	Të pazgjidhura ne fillim (1.1.XXXX)	Të pranuar	Të zgjidhura	Të pazgjidhura në fund (31.12.XXXX)	CR (%)	DT (dite)
Kosova (2014)	44,775	19,790	22,596	41,969	114.2%	678
Kosova (2017)	45,055	26,797	25,698	46,154	95.9%	656
Kosova (2018)	46,207	23,640	26,197	43,650	110.8%	608
Kosova (2020)	38,562	16,996	18,132	37,426	106.7%	753

Penale	Shkalla 2					
	Të pazgjidhura ne fillim (1.1.XXXX)	Të pranuar	Të zgjidhura	Të pazgjidhura në fund (31.12.XXXX)	CR (%)	DT (dite)
Kosova (2014)	987	2,328	2,431	884	104.4%	133
Kosova (2017)	798	1,964	2,304	458	117.3%	73
Kosova (2018)	458	1,992	2,066	384	103.7%	68
Kosova (2020)	491	1849	1714	626	92.7%	133

<sup>4</sup> Neni 13 (1.1) i Ligjit për Gjykatat Nr. 06/L-054, në kuadër të Gjykatës Themelore të Prishtinës, për lëndët nën juridiksionin e Prokurorisë Speciale, me kompetencë për tërë territorin e Kosovës.




- Në gjykatat e shkallës së parë, në vitin 2020, krahasuar me vitin 2018, numri i “Veprave të rënda” të pranuar është ulur (nga 23,640 në 16,996). Siç u shpjegua më sipër, kjo kategori përfshin çështjet penale në Departamentin e Përgjithshëm, Departamentin e Krimeve të Rënda dhe Departamentin e Posaçëm. Grafikët vijues paraqesin tre kategoritë e rasteve veç e veç.
- Rënie ka edhe numri i “Veprave të rënda” të zgjidhura: nga 26,197 në vitin 2018 në 18,132 në vitin 2020. Megjithatë, duke qenë se numri i lëndëve të zgjidhura ka qenë më i lartë se numri i lëndëve të ardhura atë vit, CR është pozitive: 106.7%. **Si trend pozitiv: numri i lëndëve në pritje për “Veprat e rënda” vazhdoi të ulet. Lëndët në pritje për “Veprat e rënda” në fund të vitit 2020 ishin 37,426.**
- **Në vitin 2020, 43% e lëndëve “Veprat e rënda” ishin mbi 2 vjet (përkatësisht: 16,016 raste nga 37426).** Këto të dhëna janë të disponueshme sepse ekziston një raport i ri statistikor i disponueshëm në SMIL që monitoron “moshën e lëndëve në pritje”.
- Në Gjykatën e Apelit, numri i lëndëve të ardhura për “Veprat e rënda” ishte gjithashtu më i ulët se në vitin 2018: 1,849 në vitin 2020 krahasuar me 1,992 në 2018. Edhe Gjykata e Apelit ka zgjidhur më pak lëndë se në vitin 2018: 1,714 krahasuar me rreth 2,000 lëndë në vitin 2018. Numri i lëndëve të zgjidhura ka qenë më i ulët se numri i lëndëve të ardhura; si rezultat, **CR ishte negative në 2020: 92.7%**. Ky është viti i parë që nga viti 2014 që CR ishte nën 100%.



- Nëse i shikojmë veçmas tri llojet e çështjeve që bëjnë pjesë në kategorinë e CEPEJ-it të “Veprat e rënda”, shohim se numri i çështjeve penale në Divizioni e Përgjithshme paraqet numrin më të madh të rasteve në kategorinë e CEPEJ-it të “Veprat e rënda.” Në vitin 2020, në Departamentin e Përgjithshme kishte 15,182 çështje penale, në Departamentin e Krimeve të Rënda 1,767 dhe në Departamentin e Posaçëm 47


çështje penale (shih. Raporti vjetor i KGJK-së për vitin 2020). Prandaj, në vitin 2020, rreth 90% e lëndëve penale në kategorinë e CEPEJ-it “Veprat e rënda” ishin lëndë penale në Departamentin e Përgjithshëm.

- Në vitin 2020 CR për të tri kategoritë ishte pozitive (mbi 100%). Megjithatë, duhet theksuar se numri i lëndëve të zgjidhura në vitin 2020 ishte më i ulët se në vitin 2018, veçanërisht për lëndët penale në Departamentin e Përgjithshëm. Në vitin 2018, gjykatat zgjidhën 24,278 çështje penale në Departamentin e Përgjithshëm krahasuar me 16,281 çështje në vitin 2020. Sa i përket Departamentit të Krimeve të Rënda, numri i çështjeve të zgjidhura ishte pak më i ulët në vitin 2020 krahasuar me 2018: 1,810 çështje penale të zgjidhura në vitin 2018 krahasuar me 1,800 në vitin 2020.
- CR ishte pozitive në Departamentin e Përgjithshëm në vitin 2020, sepse numri i rasteve të ardhura atë vit ishte më i ulët se vitet e mëparshme (15,183 çështje penale të ardhura në Departamentin e Përgjithshëm në 2020 krahasuar me 22,300 në 2018). Kjo ka rezultuar në uljen e rasteve të pazgjidhura, siç mund ta shohim më poshtë, nga rreth 40,000 lëndë në rreth 33,000 lëndë në fund të vitit 2020.



- Në nivelin e shkallës së dytë, CR për çështjet penale në Departamentin e Përgjithshëm ka rënë që nga viti 2017. Ka qenë negative në vitin 2020 (91%). CR për lëndët penale në Departamentin e Krimeve të Rënda gjithashtu ka rënie që nga viti 2014. Ishte negativ (94%) në vitin 2020. Sidoqoftë, numri i lëndëve të pazgjidhura në këto departamente është shumë i ulët (115 lëndë në fund të vitit 2020 në Departamentin e Krimeve të Rënda and 506 në Departamentin e Përgjithshëm). CR në Departamentin Special ishte pozitiv: 112%.

## Lëndë të rënda penale, DT (P94, P98, P100)



- Koha e llogaritur për përfundimin e lëndëve të pazgjidhura (DT) në vitin 2020 ishte relativisht e ulët në nivelin e Gjykatës së Apelit (133 ditë). Në të kundërtën, në shkallën e parë, koha e nevojshme për zgjidhjen e lëndëve mbeti e lartë në vitin 2020 (753 ditë).

### Kategoria e CEPEJ "Veprat e lehta"

- "Veprat e lehta" përfshijnë rastet e trajtuara nga divizioni i kundërvajtjeve në Departamentin e Përgjithshëm dhe Departamenti për të Mitur (sepse në këto raste nuk ka rrezik burgimi, duke përjashtuar rastet jashtëzakonisht të rralla).


#### P94, P98, P100: Veprat të lehta (numri absolut)

Penale	Shkalla 1					
	Të pazgjidhura ne fillim (1.1.XXXX)	Të pranuar	Të zgjidhura	Të pazgjidhura në fund (31.12.XXXX)	CR (%)	DT (dite)
Kosova (2014)	212,649	304,404	326,264	190,789	107.2%	213
Kosova (2017)	190,589	136,117	220,591	106,115	162.1%	176
Kosova (2018)	105,625	35,106	93,453	47,278	266.2%	185
Kosova (2020)	3,341	25,891	6,816	22,416	26.3%	1200


  

Penale	Shkalla 2					
	Të pazgjidhura ne fillim (1.1.XXXX)	Të pranuar	Të zgjidhura	Të pazgjidhura në fund (31.12.XXXX)	CR (%)	DT (dite)
Kosova (2014)	4	1,290	1,289	5	99.9%	1
Kosova (2017)	6	1,008	1,003	11	99.5%	4
Kosova (2018)	11	1,420	1,280	151	90.1%	43
Kosova (2020)	33	763	724	72	94.9%	36





- Departamenti i Statistikave i KGJK-së raportoi se në gjykatat themelore në fillim të vitit ishin 2,157 kundërvajtje të pazgjidhura dhe 1,184 lëndë të pazgjidhura me të mitur, që përbëjnë gjithsej 3,341 lëndë të pazgjidhura të “veprave të lehta”. Megjithatë, ky departament sqaroi gjithashtu se në fillim të vitit 2020, numri i kundërvajtjeve në pritje ishte në fakt rreth 25,000 por vetëm 2,157 ishin të regjistruara në SMIL dhe për këtë arsye ato nuk figurojnë në statistika. Këto raste janë zgjidhur jashtë SMIL-it gjatë vitit. Kjo shpjegon pse numri i rasteve të zgjidhura të paraqitura në tabelën e mësipërme është i ulët (6,816) dhe pse CT është i ulët (26%). CR për rastet që përfshijnë të mitur ishte rreth 90%.
- Numri i lëndëve “veprave të lehta” të ardhura dhe të zgjidhura është në rënie të ndjeshme që nga viti 2014 në gjykatat e shkallës së parë.
- Në apel, CR në vitin 2020 ishte 95%. Numri i lëndëve të ardhura dhe numri i lëndëve të zgjidhura është shumë më i vogël në apel sesa në gjykatat themelore. Gjithashtu, në vitin 2020, Gjykata e Apelit ka marrë më pak raste se vitet e mëparshme.



- Koha e nevojshme për zgjidhjen e lëndëve në fund të vitit (DT) për këtë kategori lëndësh është rritur ndjeshëm në vitin 2020. Megjithatë, siç u shpjegua më lart, kjo për faktin se disa raste janë zgjidhur jashtë SMIL-it dhe nuk figurojnë në statistika.

## 5. PËRFUNDIME

- Disa nga gjetjet të rëndësishme janë si më poshtë:
  - 1) Buxhetet e aprovuara për gjykatat dhe prokuroritë ishin më të larta në vitin 2020 sesa në vitin 2018 (pavarësisht shkurtimeve buxhetore shkaku i situatës me COVID-19). Buxheti i aprovuar për ndihmën juridike në vitin 2020 ishte më i ulët sesa në vitin 2018.
  - 2) Numri i gjyqtarëve u zvogëlua mes viteve 2018 dhe 2020 nga 416 në 391 gjyqtarë. Në 2020, numri i personelit që ndihmon drejtpërdrejt gjyqtarët është rritur. Numri i prokurorëve ishte afërsisht i njëjti numër me vitin 2018: 190 (numri i prokurorëve FTE: 175). Në vitin 2020 përqindja e gjyqtarëve femra ishte 34% dhe përqindja e prokurorëve femra ishte 44%.
  - 3) Lëndë civile dhe ekonomike në procedurë kontestimore në gjykatat themelore: 65,887 lëndë ishin të pazgjydhura në fund të vitit 2020 dhe 37% e këtyre lëndëve ishin më të vjetra se 2 vjet (24,273 nga 65,887). Është e rëndësishme të vazhdohet monitorimi i këtij treguesi për t'u siguruar që numri i lëndëve shumë të vjetra do të ulet.
  - 4) Është ulur numri i lëndëve të pazgjydhura civile dhe ekonomike në procedurë kontestimore në gjykatën e apelit: nga 11,994 në 9,278 në fund të vitit 2020;
  - 5) Numri i lëndëve administrative të pazgjydhura të shkallës së parë u rrit në 6,300 në fund të vitit 2020;
  - 6) Numri i lëndëve të pazgjydhura për "Veprat e rënda" në gjykatat themelore vazhdoi të ulet: 37,426 në fund të vitit 2020; dhe
  - 7) Ngarkesa me lëndë në prokurori: për qëllimin e kësaj pyetjeje, CEPEJ kërkon "numër e lëndëve", duke mbajtur të njëjtin koncept si për gjykatat. KPK sqaroi se në të ardhmen duhet të mundësohet mbledhja e këtyre të dhënave nga SMIL, për rast dhe jo vetëm për person
- Gjithsesi, duhet të kemi parasysh se viti 2020 ishte një vit shumë i vështirë për shkak të krizës pandemike që ka prekur gjithë botën. Fatkeqësisht kjo situatë e vështirë po vazhdon. Prandaj ne duhet të dyfishojmë përpjekjet tona.
- Në fund, vlen të theksohet se rritja e efikasitetit të sistemit të drejtësisë është një nga objektivat kryesore të Strategjisë së Sundimit të Ligjit 2021-2026 (fq. 26): "Kjo objektivë synon ndërtimin e një sistemi i cili trajton çështjet brenda një kohe të arsyeshme, me procedura të qarta dhe të parashikueshme, i cili pamundëson grumbullimin e lëndëve në gjykata e prokurori." Për të arritur këtë objektiv, në Planin e Veprimit të Strategjisë janë renditur disa aktivitete, të cilat Ministria e Drejtësisë pret t'i zbatojë së bashku me KGJK-në, KPK-në dhe institucionet tjera të drejtësisë.<sup>5</sup>

<sup>5</sup> <https://md.rks.gov.net/desk/inc/media/6DC1CBD5-0DF1-46AE-9D1A-78C96146C7D0.pdf>